



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V_344_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK_V_477_10_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
4. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
5. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_477_10_10**;
6. Apelimi i KEK-ut me datë 23.02.2011;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Fadil Shukolli (parashtruesi i ankesës: Nexhmedin Sadikaj), shifra e konsumatorit DPZ – 3787 nga Prizreni, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 10.03.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 27.01.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 08.11.2007 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare pran organeve të KEK-ut për lidhje të re.
Provë: Dëftesa për lidhjet e reja nr. 475 të datës 08.11.2007
- Me datë 24.06.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse, ku përfshin numrin e njehsorit 4850366 si dhe kanë vulosur njehsorin elektrik me vullë distributive nr. A 20037153.
Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 0995/D të datës 24.06.2008
- Me datë 06.08.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit, ku kanë përpiluar procesverbalin nr. 0105260 me të cilin obligojnë konsumatorin që në afat prej tetë ditësh të dorëzoj njehsorin e vjetër në KEK.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0105260 të datës 06.08.2008
- Me datë 04.11.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ08HP04469 në vlerë prej 8,835.59 €. **Provë:** Fatura DPZ08HP04469 e datës 04.11.2008



- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 27.01.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 27.01.2010
- Me datë 10.03.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 20.10.2010 DMK ka lëshuar vendimin nr. ZRRE/DMK_V_477_10_10 dhe duke u bazuar në analizat e bëra ka vendosur që të **aprovojë** ankesën e konsumatorit dhe ka arritur në përfundim se:
 1. KEK-u duhet ta shkarkoj parashtruesin e ankesës (Nexhmedin Sadikaj) nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPZ08HP04469 e datës 04.11.2008 në vlerën 8,835.59 €.
 2. KEK-u duhet të rregulloj statusin e grupit të konsumatorit, ashtu siç është kërkuar edhe nga vet punëtorët e KEK-ut, ngase sipas procesverbaleve të KEK-ut konstatohet se konsumatori i takon grupit tarifor 5 (4/02), ndërsa konsumatori është duke u faturuar në grupin tarifor 4 (7/02).

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_477_10_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së **ZRRE/DMK_V_477_10_10** të mbetet në fuqi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar